



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 15.07.2016

Ref.: 642/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të BPrAL Akademia “Evolucion” për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2021:
 - Dizajn i Modës, BA, 180 ECTS, (maksimum 120 studentë për vit akademik);
 - Dizajn i Modës, MA, 120 ECTS, (maksimumi 50 studentë për vit akademik);
 - Dizajn i Komunikimit, BA, 180 ECTS, (maksimum 60 studentë për vit akademik);
 - Dizajn i Enterierit, BA, 180 ECTS, (maksimum 60 studentë për vit akademik).
- II. Akreditohen programet e studimit për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:
 - Dizajn i enterierit, MA, 120 ECTS, (maksimum 50 studentë për vit akademik);
 - Dizajn dhe marketing, MA, 120 ECTS, (maksimum 30 studentë për vit akademik).
- III. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.
- IV. Obligohet BPrAL Akademia “Evolucion” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm te stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- V. Obligohet BPrAL Akademia “Evolucion” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të

Rekomandimeve të dhëna në raportin final nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

A r s y e t i m i

BPrAL Akademia “Evolucion” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim dhe akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Dizajn i modës	BA	180	Kadrije Brestrovci, Valdrin Sahiti, Lumnje Krasniqi
2	Dizajn i modës	MA	120	Flora Loshi, Naim Hoxha, Besim Hoxha
3	Dizajn i komunikimit	BA	180	Lirjon Kadriu, Arta Agani, Yllka Brada
4	Dizajn i enterierit	BA	180	Hana Nixha, Arben Sela, Genc Gafurri
5	Dizajn i enterierit	MA	120	Arjon Kabashi, Bashkim Shala, Muhamet Çitaku
6	Dizajn dhe marketing	MA	120	Arber Racaj, Shpetim Reznqi, Fitore Isufi

AKA ka organizuar vizitën në BPrAL Akademia “Evolucion” më 18.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Mr. Alan Brickwood dhe Mr. Stroud Cornock. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 06 korrik 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Akademia “Evolucion”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Akademia "Evolucion"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë